



BULETINI INFORMATIV

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

JANAR 2025

QENDRA E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE POGRADEC

QSHNJP Pogradec zhvilloi më 13.01.2025 një takim informues në shkollën "Nehemia" për të rinjtë mbi Kodet Penale, rolin e Zyrës së Ndihmës Ligjore Falas dhe Zyrës së Shërbimit të Provës, me qëllim parandalimin e veprave penale tek të miturit, ku morën pjesë nxënës dhe staf mësimdhënës.



QENDRA E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE ELBASAN

Më 24.01.2025, **QSHNJP Elbasan** organizoi një aktivitet informues pranë Shoqatës së të Verbërve, duke prezantuar shërbimet e ndihmës juridike falas dhe manualin në gjuhën Braille, në kuadër të Ditës Botërore të Brajtit.



QENDRA E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE PUKË

QSHNJP Pukë organizoi më 22.01.2025 një takim me titullarët e institucioneve lokale, për të diskutuar funksionin e QSHNJP-Pukë dhe strategjinë ndërsektoriale 2024-2030 të iniciuar nga Ministria e Drejtësisë.

QENDRA E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE LEZHË

QSHNJP Lezhë ishte pjesë e një takimi informues më 10.01.2025 në Qendrën Multifunktionale të Bashkisë Lezhë, ku u diskutua mbi Ndihmën Juridike Falas për gratë në proces divorci ose në vështirësi ekonomike.

QENDRA E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE TROPOJË

QSHNJP Tropojë mori pjesë më 15.01.2025 në një takim të organizuar nga Bashkia Tropojë për rastin e fëmijëve të shkëputur nga arsimiti i detyrueshëm, duke shprehur gatishmërinë për të ofruar Ndihmë Juridike Falas për të miturit, sipas ligjit 111/2017.

QSHNJP Tropojë mori pjesë më 21-22 janar 2025 në trajnimin e Shoqatës Integrimi mbi Mbrojtjen e Fëmijëve, duke diskutuar rolin e Ndihmës Juridike Falas për mbrojtjen e të miturve viktimë dhune dhe ata në konflikt me ligjin.

QENDRA E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE DURRËS

Më 23 Janar 2025, **QSHNJP Durrës** mori pjesë në një trajnim të organizuar nga KRIIK Albania, me fokus forcimin e kapaciteteve të institucioneve lokale për parandalimin e abuzimit të burimeve shtetërore për përfitim elektoral.

Më 24.01.2025, **QSHNJP Durrës** organizoi një aktivitet informues "Street Law" në ambientet e Bashkisë Durrës, duke informuar qytetarët mbi ndihmën juridike falas dhe përfitimet nga ligji 111/2017 "**Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.**"

